Njoftuar me email

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr.3073/5 Prot. Vlorë më, 06.11.2026

VENDIM

Nr.65, datë 04.11.2026

PËR

SAKTËSIMIN E VENDIMIT TË SENATIT AKADEMIK NR. 49, DATË 24.09.2026, "PËR OFRIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË 'BACHELOR' NË 'NAVIGACION', NË GJUHËN ANGLEZE"

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit nr. 879, datë 18.12.2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, 'Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë'", shkresës së Departamentit të Shkencave Detare nr. 599/5 Prot., datë 03.11.2026, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 04.11.2026,

VENDOSI:

1. Saktësimin e vendimit të Senatit Akademik nr. 49, datë 24.09.2026, duke përcaktuar se Programi i Studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në "Navigacion" do të vijojë të ofrohet në gjuhën shqipe dhe do të ofrohet gjithashtu në gjuhën angleze, për kandidatët që zgjedhin ta ndjekin në këtë gjuhë.
2. Ofrimi i programit të studimit në gjuhën shqip/anglisht do të zbatohet në mënyrë të shkallëzuar, si më poshtë:
   a) Duke filluar nga viti akademik 2026–2027, për kandidatët që disponojnë diplomë të huaj;
   b) Duke filluar nga viti akademik 2027–2028 e në vijim, për të gjithë kandidatët, pavarësisht nëse disponojnë diplomë të huaj apo diplomë të fituar në Republikën e Shqipërisë.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

3. Ngarkohet Zëvendësrektori Akademik, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmëse Akademike për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËN KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Asoc . Denada Sota